

Metodologjia e së drejtës – hulumtuese

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Juridik
Titulli i lëndës:	Metodologjia e së drejtës – hulumtuese
Niveli:	Master
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti pare, Semestri veror
Numri i orëve në javë:	2
Vlera në kredi – ECTS:	3
Koha / lokacioni:	Prishtinë, e marte, prej ores 10:00-12:00
Mësimdhënësi i lëndës:	Osman Ismaili
Detajet kontaktuese:	osmani1949@gmail.com
Përshkrimi i lëndës	
	<p>Në kuadër të plan programit akademik për lëndën mësimore të Fakultetit Juridik në Prishtinë, lëndë obliguese për semestrin veror në programin e vitit të vitit parë të studimeve master ka lëndën METODOLOGJIA E SË DREJTËS HULUMTUESE (Metodat e Hulumtimit shkencor) me fond javor për grupin përkatës prej dy (2) orëve mësimore - ligjërata.</p> <p>Metodologjia e së drejtës hulumtuese është disiplinë shkencore e përgjithshme juridike e cila merret me ofrimin e njohurive lidhur me metodat e së drejtës të cilat përdoren në rastet kur merremi me të drejtën qoftë në aspektin teorik apo atë praktik. Metodatat e njohjes janë të ndryshme, madje shumë të ndryshme nga metodatat praktike, pra , nga metodatat teknike juridike. Pastaj, metodatat e njohjes të së drejtës gjithashtu dallohen duke pasqyruar se a është fjala për metodatat filozofike apo ato shkencore. Kështu krijohet disiplina unike e cila do të merret me studimin e të gjitha metodave të njohjes dhe metodave të krijimit të së drejtës dhe të zbatimit të së drejtës, gjegj., të metodave teknike juridike.</p>
Qëllimet e lëndës:	Objektivi i kësaj lënde është që t'iu ofrohen studentëve njohuri lidhur me nocionin e metodës, të njihen me llojet e metodave shkencore të cilat përdoren për të hulumtuar dukuritë juridike shtetërore, pra, me metodatat të dhënat e fituara të cilat mund të provohen – verifikohen nëpërmjet përvojës, për dallim nga përdorimi i metodave filozofike me të cilat fitohen të dhëna por të cilat

	nuk mund të përçohen – verifikohen me anë të përvojës. Natyrisht, se metodologjia e së drejtës ofron njohuri lidhur me metodat ideale (dogmatike dhe normative); ofron njohuri lidhur me metodat shoqërore – sociologjike dhe përdorimin e tyre si edhe metodat psikike për të pas rezultatet të kënaqshme për dukuritë përkatëse. Natyrisht, se pjesën hulumtuese duhet kompletuar edhe me njohjet që fitohen duke përgatitur dhe pas literaturën adekuate për anën praktike të një punimi kërkimor shkencor nga lëmi përkatës.
Rezultatet e pritura të nxënies:	<p>Të kenë opinionin e vet lidhur me nocionin e metodës dhe metodave në përgjithësi atyre shkencore të cilat do të përdoren për të njohur dhe studiuar një dukuri juridike shoqërore;</p> <p>Të njihet me metodat ideale të cilat përdoren vetëm në shkencat juridike së bashku me metodat reale - metodën sociologjike;</p> <p>Të ketë mundësi të bëjë dallimin e mirëfilltë të metodës dogmatike – normative prej metodave të tjera të njohjes të së drejtës;</p> <p>Të bëjë njohjen dhe dallimin ndërmjet metodave shkencore prej atyre filozofike dhe të kenë mundësi të njohë mundësin e përdorimit të tyre të nevojshëm për dukuritë të cilat hulumtohen pa pengesa.</p>

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	2	14 javë	28 orë
Ushtrime teorike/laboratorike	1	14 javë	14 orë
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	5	-	5 orë
Ushtrime në teren			
Kollokfiume,seminare	4	-	4 orë
Detyra të shtëpisë	5	-	5 orë
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	14 javë	28 orë
Përgaditja përfundimtare për provim	3	1 javë	3 orë
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	3	1 javë	3 orë
Projektet,prezentimet ,etj	1	1 javë	1 orë
Totali			91 ore

Metodologjia e mësimdhënies:	Interaktive, përmes pyetjeve dhe përgjigjjeve, ndarja në grupe të vogla diskutuese, përmes prezantimeve, punimeve seminarike, testeve provuese.
Metodat e vlerësimit:	Vlerësimi i studentëve do të bëhet mbi bazën e kriterëve të përgjithshme që zbatohen në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës në përputhje me aktet dhe rregulloret normative – pozitive. Në këtë lëndë mësimore studentët do të vlerësohen sipas komponentëve të mëposhtme. <ul style="list-style-type: none"> - Frekuentimi i rregullt i orëve të mësimit 10%; - Pjesëmarrja aktive në debat gjatë mësimit 10%; - Punimi eventual i ndonjë seminari nga lëmi i së drejtës 30%; Provimi final 50%.
Literatura	
Literatura bazë:	<i>Dr.sc. Radomir Lukiq: Metodologjia e së drejtës, (shqipëroi dhe përshtati Dr.sc.Osman Ismaili, prof.i rregullt), Prishtinë, 2015:</i>
Literatura shtesë:	<i>Dr.sc. Hanz Kelzen: Teorija e përgjithshme e së drejtës dhe shtetit, Përkthim në gjuhën serbokroate, Beograd, 1951;</i> <i>Dr. sc. Berislav Periq: Njohja shkencore dhe dialektika (Pravna znanost i dialektika), Zagreb, 1962;</i> <i>Dr.sc. Mit'hat Shamiq: Si shkruhet vepra shkencore, Sarajevë, 1988, (përktheu dhe bo toi shtëpia botuese Logos - Shkup, 2006;</i> <i>Dr. sc. Fuad Saltaga: Metodologjia drustvenih i pravnih nauka, Sarajevë, 2005;</i> <i>Stavileci, dr. Esat: Të menduarit dhe të shkruarit juridik, Prishtinë,2013.</i>
Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
Java e parë:	Njoftim i studentëve me planprogramin e lëndës
Java e dytë:	<i>Emërtimi dhe karakteri i metodologjisë të së drejtës: emërtimi, nocioni i metodologjisë, metodologjia si disiplinë e meta – njohjes; metodologjia e së drejtës si disiplinë e meta njohjes. Lënda e metodologjisë të së drejtës, Nocioni i lëndës së Metodologjisë të së drejtës; Nocioni i metodës; Njohjet paraprake si metodë; Lënda dhe metoda; Metodatat e përgjithshme dhe të veçanta;</i>

Java e tretë:	<i>Metoda dialektike si metodë e përgjithshme; Metoda e materializmit historik si metodë e përgjithshme; E veçanta e metodave juridike. Metoda e Metodologjisë të së drejtës; Nocioni dhe llojet e metodave të metodologjisë të së drejtës; Zbatimi i metodave reale për njohjen e metodave juridike; Zbatimi i metodave reale për vlerësimin e metodave juridike. raporti metodologjisë të së drejtës me disiplinat e tjera dhe zhvillimi historik i saj; Raporti i metodologjisë të së drejtës me disiplinat e tjera si edhe Zhvillimi dhe statusi i Metodologjisë të së drejtës</i>
Java e katërt:	<i>Metodat e njohjes të së drejtës: Nocioni dhe llojet e metodave të njohjes të së drejtës; Nocioni i metodës së njohjes të së drejtës; Llojet e metodave të njohjes të së drejtës; Raporti i filozofisë me shkencën; Vlefshmëria e filozofisë; Zhvillimi historik i metodës së njohjes të së drejtës. Metodat filozofike të njohjes të së drejtës</i>
Java e pestë:	<i>Metodat shkencore të njohjes të së drejtës; Nocioni i shkencës; Llojet e shkencave; Metoda shkencore e njohjes; Natyra e së drejtës; Metodat e varura dhe metodat e pavarura si metoda të njohjes të së drejtës. Metodat shkencore të pavarura të njohjes të së drejtës; Metodat reale; Metoda sociologjike dhe e drejta</i>
Java e gjashtë:	<i>Metodat ideale, Metoda dogmatike; Metoda e interpretimit të së drejtës; Vlefshmëria e metodës dogmatike; Nocioni i metodës normative; Vlefshmëria e metodës normative; Metodat shkencore të varura të njohjes të së drejtës; Metoda historike juridike dhe metoda krahasues</i>
Java e shtatë:	Kolokviumi i parë
Java e tetë:	<i>Metodat teknike të së drejtës; Nocioni teknikës juridike; shkenca dhe teknika; Metodat teknike; Teknika juridike; Nocioni i teknikës juridike; Raporti i shkencës juridike dhe teknikës juridike; Metodat teknike juridike; Llojet e metodave teknike juridike</i>
Java e nëntë:	<i>Metodat e krijimit të së drejtës; Nocioni dhe llojet e krijimit të së drejtës; Nocioni i metodave të krijimit të së drejtës; llojet e metodave të krijimit të së drejtës. Krijimi spontan i së drejtës – e drejta zakonore; Krijimi i vetëdijsëm dhe i planifikuar i së drejtës; Procedura e përgjithshme e krijimit të vetëdijsëm dhe të planifikuar të së drejtës; Metodat e veçanta të krijimit të vetëdijsëm dhe të planifikuar të së drejtës; Krijimi i së drejtës nëpërmjet normave individuale; Në shoqërinë e pazhvilluar; Në shoqërinë e zhvilluar; Krijimi i së drejtës nëpërmjet normave të përgjithshme</i>
Java e dhjetë:	<i>Krijimi i së drejtës nëpërmjet normave të përgjithshme në formën e normave individuale; Praktika juridike; Precedenti</i>

	<i>juridik; Krijimi i së drejtës drejtpërdrejt nëpërmes normave të përgjithshme; E drejta zakonore; Legjislacioni; Nocioni i kodifikimit; Rëndësia e ligjit; Procedura e kodifikimit; Metodatat e kodifikimit; Ndërtimi nga ekspertët – ndërtimit me ndikim të madh nga jo ekspertët; Metodatat nëpërmes të cilave ligjet u bëhen të njohura masave të gjëra – popullit</i>
Java e njëmbëdhjetë:	<i>Forma juridike; shëndrrimi i realitetit të rëndomtë në realitetin juridik; Forma juridike; Nocioni i formës juridike; elementet e formës juridike; Nocionet juridike, Konstruksionet juridike; Parimet juridike; Gjuha juridike Raportet juridike; Punët juridike dhe Forma e punëve juridike</i>
Java e dymbëdhjetë:	<i>Metodat e zbatimit të së drejtës; Nocioni i zbatimit të së drejtës dhe metodatat e tyre; Metodatat e zbatimit të normës së përgjithshme në rastin konkret; Metoda klasike; Metoda kibernetike; Interpretimi i normës së përgjithshme; Vërtetimi i fakteve; Provat; Supozimet dhe fiksionet juridike; Norma individuale e cila përdoret për ta zbatuar normën e përgjithshme juridike</i>
Java e trembëdhjetë:	<i>Java e dhjetë i përket anës praktike të të shkruarit ligjor nëpërmes literaturës shkencore e cila do të mundësoj njohjet e shkrimit akademik lidhur me hartimin e punimeve të diplomës në Master programin dhe në hartimin e disertacionit të doktoratës.</i>
Java e katërbëdhjetë:	<i>Do të diskutohet lidhur me metodën dhe veprën shkencore – hulumtuese; Cilësitë themelore të punës dhe metodës shkencore – hulumtuese; Veçoritë e veprës së mirë shkencore, Zgjedhja e temës; Hulumtimi i dokumentacionit, Zbulimi i dokumenteve, Hartimi i bibliografisë së punës, Skedat për librat, skedat për artikuj në revista dhe gazeta, Dy biblioteka të huaja shkencore dhe puna në to, Biblioteka Kombëtare e Kosovës; Tubimi i lëndës, leximi dhe kritika e teksteve, shkrimi i shënimeve; organizimi dhe sistemimi i lëndës së tubuar, redigjimi i dorëshkrimit, të shkruarit e tekstit; Koncepti, Teksti përfundimtar. Citatet; fusnotat; Bibliografia përfundimtare; Lekturimi i punimit; Përpunimi teknik dhe shtypja e dorëshkrimit; Korrektura dhe shtypja; Shenjat dhe shembujt e përmirësimeve, Mbrojtja e tezës; Ekspozeu i kandidatit; Vërejtjet kritike dhe pyetjet e referentëve; Përfundimit</i>

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Vijueshmëria në ligjerata dhe ushtrime është obligative për të gjithë studentët e rregullt, përveq rasteve të arsyeshme të mungesës së raste të caktuara.

Qetësia gjatë orës së ligjeratës apo ushtrimeve është esenciale në suksesin e lëndës andaj studentët duhet të mbajnë qetësinë në nivelin e duhur.

Interaktiviteti gjatë ligjeratave dhe ushtrimeve është pjesë e rëndësishme e mësimdhënies dhe të gjithë studentët janë të inkurajuar që të marrin pjesë në mënyrë aktive. andaj studentët të cilët kërkojnë që të inkuadrohen dhe të japin mendimin e tyre në lidhje me temat e caktuara në kuadër të syllabusit të kësaj lënde mund të ngrisin dorën për të marrë fjalën.

Kontakti me profesorin apo asistentin e lëndës mund të zhvillohet gjatë orëve të konsultimeve ose përmes emailit zyrtar.